



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-14703/2026
Kaçanik, 30.06.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 29.06.2026 (e hene), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendi i Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 19 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari Betim Shala. Konstatohet se pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 19 anëtarë. Mungoj me arsye 1 anëtarë: Elona Gjini . Nga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, 09 drejtor të drejtorive. Nga zyrtarët: Zyrtari i IT, Asistentja e Kryesuesit të KK dhe këshilltarja e kryetarit gjithashtu në fillim të mbledhjes ka marrë pjesë dhe gazetari Alban Muhaxheri. Mbledhja ka qenë në transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Arianita Bajrami – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit .

Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni: Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur me emër, një anëtar, Elona Gjini mungojn me arsye. Kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VI-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 29.06.2026, me këtë:

Para se të kalohej në rendin e punës kryesuesin e ndërpreu znj. Kadrie Lika Troni duke kërkuar që:

znj. Kadrie Lika Troni: Në emër të grupit të asambleistëve kërkoj nga ju që të bëni tërheqjen e fjalës ofenduese të mbledhjes së KPF ku me atë rast unë dhe kolegja ime jemi fyer me atë fjalë, gjithashtu kërkoj edhe nga kryetari të bëj një distancim nga ajo që është thënë, ko është njerëzore i ndodh gjithkuj por kërkim falja është pjesë e punës dhe institucionit.

z. Selajdin Troni: Faleminderit shumë, vazhdojmë me rendin e ditës:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;
3. Propozim Vendim për Riorganizimin e Gjendjes Civile, përkatësisht Shuarjen e Zyrave të vendit (**hequr**);

4. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 941/01-11177/21 të datës 29.04.2021 për lejin e ndarjes së parcelës Nr. 649-0 ZK Kaçanik PSH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;

5. Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025', hartuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin,

z. Jeton Luma: Meqenëse neve na ka ardhë njoftimi për këtë pikë a mund ta dimë arsyen pse është larguar kjo pikë nga rendi i ditës. Unë herën e kaluar kam bërë pyetje për këtë cështje.

z. Sabedin Vishi: Është llogaritur se do vijë në kuvend cështja për zyret e vendit në përgjithësi, në bazë të raporeve që kemi bërë mendojmë se duhet të funksionojnë akoma. Nuk mendoj që duhet me debat për këtë pikë sepse është largu në KPF. Sa i përket për zyret e vendit në Gllloboqicë te vjen përgjigja me shkrim.

Nëse nuk ka të tjerë atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

z. Selajdin Troni: A ka dikush dicka rreth procesverbalit?

znj. Kadrie Lika Troni: Fillimisht kryesues më vjen shumë keq që kërkesën që e bëra nuk e bëre sepse ai është akt moral i secilit këtu dhe ti këtu po jep një shembull të keq për gjithë kolegët asambleist. Sa i përket procesverbalit, tek ky nuk kam vërejtje por kërkoj që në procesverbalin e mbledhjes së KPFsë të shënohet cdo fjalë që është përmendur sepse ne nuk do ta lëmë me kaq por do ta adresojmë vërejtjen në MAPL.

z. Selajdin Troni: Në rregull Kadrie ju mendoni ashtu, unë nuk mendoj që e kam thënë atë fjalë. A ka dikush dicka për procesverbalin nëse jo e hedh në votim. Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri. Prezent 20. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja V (pestë) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 30.04.2026/ Lënda: 01Nr. 060/01-8988/2026.

Pyetjet dhe Kërkesat

z. Jeton Luma: Kërkesa e parë ka të bëjë me lagjen Fshati i Vjetër, aty ndodhet një përrua i cili nuk është pastruar asnjëherë e për shkak të sasisë së madhe të ujrave që grumbullohen aty është shumë e nevojshme që të parandalohet e mundshem të një vërshimi në atë pjesë, arsyja tjetër është për sigurinë e qytetarëve, unë po ua paraqës këtë rrugë që është shkruar para pak vitesh dhe mundeni me pa urën e cila nuk ka kurrfar masash mbrojtëse dhe paraqet rrezik për qytetarët dhe kërkoj që të rregullohet dhe të sigurohet infrastruktura e duhur mbrojtëse.

Kërkesa e dytë meqenëse nuk ka pasur investime në infrastrukturë rrugore që sa kohë në Gllloboqice kërkoj që të fillohet me asfaltimin e segmenteve rrugore në të cilat nuk janë asfaltuar asnjëherë bëhet fjalë për rrugën “Veli Ballazhi”, rruga tjetër e cila nuk ka emer fare por jeetojnë 4 familje, është segment i shkurtër por i rëndësishëm për këto banorë. Kërkesa e tretë ka të bëjë me fshatin Strazhë, botërisht dihet që ai është një vend është një nga pikat më vitale të komunës sonë dhe që ka më së shumti potencial ekonomik bukuritë natyrore janë aset i cmuar por që ti shëndrrojmë në një destinacion na duhet vizion dhe një menaxhim të mirëfilltë . këtij ambienti i mungojnë parkingjet dhe banjat publike. Tjetër çështje që dua të adresoj është edhe siguria e vizitorëve nga mjetet motorike e pakontrolluara.

znj. Lejla Caka: Kam në kërkesë nga banorët e e fshatit Bob që të rregullohet ndriqimi publik në lagjen Caka, Dema, Zeneli sepse ka kohë që nuk punon.

z.Xhelal Ceka: Lagja e vjetër e fshatit Gllloboqicë, ka nevojë për ndriqim dhe trotuar. Lagja Farizve nuk është marr asnjë hap për rregullim sipas tyre dhe duhet dalë të dëgjohen hallet e këtyre qytetarëve, njëkohësisht edhe lagjja në rrugën Veli Ballazhi ka nevojë për ndriqim publik, rruga Rufat Ceka dhe Hisen Ceka kanë nevojë për asfaltim dhe ndriqim. Fshati Strazhë ka nevojë për mirëmbajtje publike propozoj që të punësohet një person fizik për mirëmbajtje, Fshati Kashan ka nevojë urgjente për ujë të pijëshëm. E fundit është asfaltimi i rrugëve, dhe pastrim të tyre në lagjet Lamaj, Kastrat, Tifek dhe Cakaj në Dubravë.

z. Islam Gashi: Si fillim dua të paraqes një ankesë të lagjes të heq dheun kompania që i ka bërë punimet e parkut, dheu është hedhur nëpër rrugën Komandant Bardhi. Kërkesa dytë ka të bëjë se edhe pse kanë kaluar 7 muaj nga kur kemi dhënë betimin si Asambleist akoma në faqen e komunës akoma figurojnë emrat dhe kontaktet e asambleistëve të kaluar, kërkoj që këto të dhëna të përditësohen.

znj. Ardita Rrahmani: Me punimet e InfraKosit ne Stagovë a keni informatë se kur pritet të përfundohen punimet dhe riparimi i asaj pjese dhe poashtu në fshatin Doganaj përkatësisht në Koxhaj dhe Dedaj qysh tash kanë filluar të kenë mungesë të ujit të pijëshëm a mundeni me kërku nga Bifurkacioni sqarime dhe kërkoj nga DSHPE të filloj pastrimi i shtratit të lumit Nerodime drejt Xhamisë së Dëshmorëve.

znj. Ernesta Krasniqi: Pyetja e parë ka të bëjë me problemin e qenëve endacak, prania e tyre shkakton rrezik për sulmim ndaj qytetarëve dhe ata duan të dinë a po merret ndonjë masë sigurie për ta, kërkesa e dytë ka të bëjë me urën e cila gjendet tek Matlunt që të renovohet sepse dëmtimi po shkakton shumë zhurmë gjatë kalimit nëpër të dhe kërkesa e tretë ka të bëjë me rrugën “Gryka e Kacanikut”, në Kacanik të Vjetër, banorët kanë shprehur pakënaqësi për ritmin e ngadaltë, kërkojmë të dimë se a po ushtrohen mbikqyrje dhe kur priten të përfundohen këto punime.

z. Kjani Zeneli: Deri më tani asnjë kërkese e imja nuk është marrë parasysh, Poashtu edhe përgjigjet po ipen shumë të cekta dhe të mangëta. Kërkesat që i kam bërë për lagjen Bob she për trotuarin tek shkolla Idriz Seferi nuk janë marrë parasysh. Lagja Zeneli dhe Caka kanë mungesë rryme vazhdimisht andaj kjo gjë duhet të rregullohet. Ne në Bob kemi marrë një vendim që të ngrisim një lapidar, kemi ra në marrveshje me banoret e atij vendi që nuk pengon, parcela gjendet përkatësisht përball shtëpisë se z. Mehmet Zeneli. Komuna duhet ta ndajë atë parcelë që ne të mund të fillojmë punimet.

Znj. Hafize Sallahu: Duke qenë se është sezona e mërgimtarëve desha të pyes a është menduar të siguroen vendparkingje për afatin kohor sa janë ata në Kosovë.

Znj. Shqipe Murseli: Perroi për shkarkimin e ujrave atmosferike përgjatë rrugës Kemal Kolshi ka nevojë për riparim, sepse rrezikohet dalja nga shtrati. Pranë shkollës Ali Asllani kërkohet asfaltimi i rrugës nga shkolla deri tek rruga e tetoves, dhe sinjalizimin. Shpronësimi i pronës private me numer 1740 për të cilën desha të di a ka dicka të re.

znj. Kadrie Lika Troni: Kam pranuar një ankesë e cila i drejtohet Drejtorisë së Bujqësisë nga banori Adil Thaci në Kovaqec, gjatë punimit të kanalit të ujitjes është punuar në pronën e tij private dhe është dëmtuar po ajo pronë, kërkoj nga ju të bëhet verifikimi i kësaj ceshtje.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje e kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;

E hapi diskutimin drejtor:

z.Valdrin Dogani: Sot para jush po paraqesim për shqyrtim Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Kaçanikut për periudhën 2027–2029.

Korniza Afatmesme Buxhetore është dokumenti kryesor i planifikimit financiar trevjeçar të Komunës. Ajo nuk është ende buxheti përfundimtar, por përcakton orientimin, prioritetet dhe kufijtë mbi të cilët do të hartohet propozim-buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028 dhe 2029.

Dokumenti është përgatitur në bazë të legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe financat lokale, Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2027–2029, Qarkores Buxhetore 2027/01, Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2030, të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2024 dhe propozimeve të drejtorive komunale.

Gjatë hartimit është ndjekur parimi që fillimisht të sigurohen obligimet ekzistuese, shpenzimet esenciale rrjedhese dhe projektet në vazhdim. Vetëm pas tyre janë trajtuar politikat dhe projektet e reja.

Prioritetet për periudhën 2027–2029 janë organizuar në pesë fusha kryesore:

E para, nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal, përmes mbështetjes së bizneseve, investimeve, inovacionit, digjitalizimit dhe zhvillimit të turizmit.

E dyta, përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban, me fokus në rrugë, trotuare, kanalizime, ujësjellës, ndriçim publik, ura dhe hapësira publike.

E treta, zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit, përmes subvencionimit të fermerëve, përmirësimit të mekanizimit, rrugëve fushore, kanaleve të ujitjes, mbrojtjes së tokës, pyjeve dhe burimeve ujore.

E katërta, përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi, arsim, mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport.

E pesta, fuqizimi i qeverisjes lokale dhe rritja e efikasitetit administrativ, përmes digjitalizimit, përmirësimit të shërbimeve për qytetarët, transparencës dhe zhvillimit profesional të stafit.

Sa i përket kornizës fiskale, buxheti i planifikuar për vitin 2027 është 14,060,883 euro, që paraqet rritje prej 661,130 euro ose 4.93 për qind krahasuar me vitin 2026.

Për vitin 2028 buxheti vlerësohet në 14,564,382 euro, ndërsa për vitin 2029 në 15,338,067 euro.

Financimi vazhdon të mbështetet kryesisht në grantet qeveritare, ndërsa të hyrat vetanake janë planifikuar në 1,203,387 euro për vitin 2027, me rritje graduale deri në 1,303,689 euro në vitin 2029.

Kjo rritje e të hyrave vetanake kërkon përmirësimin e evidencave, regjistrimin dhe verifikimin e pronave, faturimin e rregullt, përcjelljen e obligimeve dhe zbatimin e masave të ligjshme për inkasim.

Në dokument janë paraqitur ndarjet e planifikuara sipas programeve dhe kategorive ekonomike: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe investime kapitale.

Sa u përket investimeve kapitale, për periudhën 2027–2029, vlera e përgjithshme e planifikimit kapital është 11,395,540 euro: 3,337,000 euro për vitin 2027, 3,694,540 euro për vitin 2028 dhe 4,364,000 euro për vitin 2029.

Projektet përfshijnë investime në infrastrukturën rrugore, kanalizime, hapësira publike, bujqësi, turizëm, shëndetësi, shërbime sociale e rezidenciale, kulturë, sport dhe arsim.

Ky dokument paraqet orientimin fillestar. Gjatë fazës së hartimit të propozim-buxhetit do të zhvillohen edhe dëgjimet buxhetore dhe do të shqyrtohen kërkesat e qytetarëve, drejtorive dhe grupeve të interesit, gjithmonë brenda kufijve buxhetorë të përcaktuar.

Prandaj, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit Komunal mbështetjen dhe aprovimin e kornizes afatmesme buxhetore të komunes së Kacanikut për periudhën 2027-2029.

z. Islam Gashi: Në shqyrtim të dokumentit vërehet një mospërputhje mes asaj që thotë teksti dhe asaj çfarë thonë numrat. Ky dokument paraqet objektiva të shumta zhvillimore duke përmendur zhvillimin ekonomik, turizmin, digjitalizimin, bujqësinë, mjedisin, arsimin dhe përfshirjen sociale. Megjithatë kur analizojmë daljen konkrete të mjeteve financiare krijohet një hendëk mes asaj që premtohet dhe asaj cka financohet. Prioritet kryesor thuhet të jetë zhvillimi ekonomik dhe të tjera, por nëse shkojmë tek tabela e ndarjes buxhetore të vitit 2027 shohim që nga kodi buxhetor i planifikimit dhe zhvillimit ekonomik është ndarë një shumë simbolike prej 200,000€ ose 1.43% e buxhetit të komunës, prej tyre rreth 110,000€ kanë shkuar për investime kapitale dhe rreth 50,000€ për subvencione. Ekzekutivi e ka listuar zhvillimin bujqësisë dhe turizmit si një ndër shtyllat kryesore për zhvillimin ekonomik përmes edhe rritjes së serrave bletarinë dhe pikat turistike, por kur shkojmë tek tabela e investimeve kapitale nuk shohim se ku janë të vendosura paratë për turizmin. Nëse këto janë prioritete strategjike atëherë pse janë nda vetëm 120,000€ tek subvencionet dhe 80,000€ në investime kapitale. Gjithashtu Komuna përmend edhe modernizimin e administratës dhe digjitalizim i shkollave, por shohim që janë të ndara vetëm 80,000€ për digjitalizimin e SHMU dhe 30,000€ për SHML ndërkajë nuk ka mjete të ndara administrata për investime në softëer apo trajnimin e stafit. Në kornizën afatmesme buxhetore po na paraqitet edhe një ulje prej afro 270,000€ tek granti specifik për arsim por nuk kemi asnjë analizë apo shpjegim për ndikim apo si do të mbrohet cilësia e arsimit me këtë ulje. Gjithashtu përmenden edhe çështjet gjinore por buxheti për këtë kategori ka pësuar një ulje prej 2,000€. Thuhet në këtë dokument është marrë për bazë edhe regjistrimet e popullsisë në 2024 dhe propozimet e drejtorëve komunal, andaj si ka mundësi që fshati Begracë nuk figuron në asnjërën tabelë për propozim projekt pasi që dihet se është fshati i dytë për nga numri i banorëve në Komunën tonë. Dua ta pyes edhe drejtorin për Kulturë Rini dhe Sport gjatë gjithë bisedave që i kemi pasë më është thënë që pas ndëtimin të terreneve sportive në Stagovë dhe Kovaqec do vazhdojmë edhe për në Begrac ndërkajë në këtë Kornizë nuk figuron që janë nda mjete për këtë terren.

z. Heset Malsiu: 1. Përdorim i tepruar i tekstit nga Strategjia (Copy-Paste)-Një pjesë e konsiderueshme e dokumentit është marrë pothuajse e pandryshuar nga Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal. KABK nuk duhet të jetë version i shkurtuar i Strategjisë, por dokument financiar që analizon dhe përkthen prioritetet strategjike në investime konkrete. Mungon analiza financiare dhe buxhetore që justifikon përzgjedhjen e investimeve.

2. Mungon analiza e prioritizimit të projekteve-Dokumenti nuk shpjegon pse një projekt është prioritar ndaj një tjetri. Nuk ekziston analizë krahasuese ndërmjet projekteve. Nuk argumentohet ndikimi ekonomik, social apo mjedisor i secilit projekt. Prioritetet janë deklaruar, por nuk janë arsyetuar.

3. Mungon sistemi i pikëzimit të projekteve -Nuk janë përcaktuar kriteret mbi të cilat janë përzgjedhur investimet. Nuk ekziston një metodologji transparente e vlerësimit. Mungon matrica e prioritizimit sipas: ndikimit ekonomik, numrit të përfituesve, gatishmërisë së projektit, urgjencës, përputhshmërisë me Strategjinë.

4. Mospërputhje ndërmjet prioritetëve strategjike dhe investimeve kapitale - Strategjia vendos zhvillimin ekonomik si prioritet kryesor, derisa në investimet kapitale nuk shihet e njëjta logjikë prioritizimi, disa investime administrative marrin përparësi ndaj projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik.

5. Shpërndarje jo optimale e mjeteve financiare -Nuk argumentohet pse fondet janë shpërndarë në këtë mënyrë. Nuk analizohet nëse disa projekte mund të shtyhen për t'i dhënë përparësi projekteve me ndikim më të madh ekonomik. Nuk paraqiten alternativat e mundshme të financimit.

6. Projekte strategjike me ndikim ekonomik nuk trajtohen si prioritare

Shembull: rruga **Silkapor-Rakaj** është projekt me rëndësi strategjike për lidhjen me zonën ekonomike dhe zhvillimin e biznesit, projekti është shpërndarë në disa vite, duke vonuar efektet ekonomike, në të njëjtën kohë financohen projekte administrative që mund të shtyeshin për një periudhë më të vonshme.

7. Projektet janë tepër të përgjithësuara-Në shumë raste shkruhet vetëm: Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve; Ndërtimi i infrastrukturës urbane; Ndërtimi i infrastrukturës rurale; Përmirësimi i ujësjellësit; Përmirësimi i kanalizimit. Këto nuk janë projekte, janë vetëm kategori investimesh.

8. Nuk specifikohen projektet konkrete - Dokumenti nuk tregon: cilat rrugë ndërtohen; cilat rrugë rehabilitohen; cilat lagje përfitojnë; cilat fshatra përfitojnë; cilat kolektorë ndërtohen; cilat kanalizime ndërtohen; ku ndërtohen trotualet.

Kjo e bën të pamundur vlerësimin real të investimeve.

9. Nuk paraqiten tregues fizikë të investimeve - Për secilin projekt duhet të paraqiten: kilometra rrugë; metra kanalizim; metra ujësjellës; sipërfaqe parqesh; numri i urave; numri i ndriçuesve publikë.

Në dokument mungojnë pothuajse të gjithë këta tregues.

10. Mungon ndarja sipas lokaliteteve - Dokumenti nuk tregon: në cilin fshat; në cilën lagje; në cilën rrugë; në cilin lokalitet, do të realizohen investimet.

Kjo ul transparencën dhe pamundëson monitorimin nga Kuvendi dhe qytetarët.

11. Mungon lidhja ndërmjet objektivave dhe projekteve - Nuk ekziston një tabelë që tregon: **Objektivi strategjik → Projekti → Buxheti → Afati → Rezultati**

Si rrjedhojë nuk mund të vlerësohet nëse investimet realizojnë objektivat strategjike.

12. Matësit e performancës janë shumë të përgjithshëm Përdoren indikatorë si: numri i projekteve; numri i aktiviteteve; numri i përfituesve. Mungojnë indikatorët realë të ndikimit, si: rritja e punësimit; rritja e investimeve private; rritja e të hyrave komunale; ulja e kostove të shërbimeve; përmirësimi i qasjes në infrastrukturë.

13. Mungon analiza kosto-përfitim - Për asnjë projekt nuk paraqitet: ndikimi ekonomik; ndikimi social; ndikimi financiar; përfitimet afatgjata. Prandaj nuk mund të vlerësohet efikasiteti i investimeve.

14. Mungon analiza e ndikimit zhvillimor - Dokumenti nuk tregon: cilat projekte krijojnë vende pune; cilat rrisin konkurrueshmërinë; cilat ndikojnë në zhvillimin e bizneseve; cilat ndikojnë në zhvillimin rural.

15. Mungon analiza e alternativave - Nuk është analizuar: a mund të shtyhen disa projekte; a mund të realizohen në faza; a mund të bashkëfinancohen; a mund të financohen nga donatorët.

16. Mungon analiza e rrezikut - Dokumenti nuk identifikon: pasojat e mosrealizimit; mungesën e financimit; vonesat procedurale; ndikimin e inflacionit; rritjen e kostove.

17. Nuk argumentohet renditja e investimeve shumëvjeçare - Nuk shpjegohet: pse një projekt realizohet në tri vite; pse një tjetër realizohet menjëherë; pse disa projekte marrin më shumë financim në vitin 2027.

18. Dokumenti nuk reflekton plotësisht nevojat reale të zhvillimit

Edhe pse Strategjia identifikon sektorët prioritarë, KABK nuk i përkthen këto prioritete në investime konkrete me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe social.

Konkluzion

Në tërësi, KABK 2027–2029 paraqet një dokument të përgatitur mirë në aspektin formal, por me mangësi të rëndësishme metodologjike. Problemet kryesore lidhen me mungesën e një procesi transparent të prioritizimit, përdorimin e tekstit të Strategjisë pa analizë të shtuar, përgjithësimin e projekteve në vend të specifikimit të tyre dhe mungesën e lidhjes së qartë ndërmjet objektivave strategjike, projekteve kapitale dhe shpërndarjes së mjeteve financiare. Këto mangësi e bëjnë më të vështirë vlerësimin objektiv të dokumentit dhe kufizojnë transparencën e procesit të planifikimit buxhetor.

znj. Kadrie Lika Troni: Sot po diskutojmë- për KABK dokument që supozohet të projektoj zhvillimin strategjik të Kacanikut. Por ne nuk mund të flasim me ndërgjegje të pastër derisa në letër shohim shifra por në terren kollaps të ekonomisë sonë lokale. Kacaniku nuk ka treg për tregëtarët dhe ska as planifikim në KAB. Kryetar po u pyes se a keni menduar ndonjëherë për këtë çështje dhe si ka munësi që në këtë kornizë nuk keni përfshirë anjë plan konkret për tregëtarët tanë. Ky dështim i qeverisjes tuaj prej 26 vitesh ka prodhuar krizë të trefishtë që nuk mund të fshihet pas këtij dokumenti. Tregëtarët u dëbuan nga Kalaja , ish stadiumi, parcela ku u ndërtua Viva-Freshi dhe sëfundmi dhe nga prona private ku tash e një vit ata kanë mbetur pa asnjë hapsirë në rrugë të hapur dhe pa mundësi për të mbajtur familjet e tyre. Në shekullin 21 ku konsumatorët tonë detyrohen të furnizohen mbi trotuare e nëpër pluhur ndërtimesh duke ndikuar direkt në sanitari, higjienë e shëndet. Komuna ka dështuar të sigurojë një hapsirë të vetme publike për tregun e përbashket të qytetit, andaj kam një pyetje për kryetarin, pse nuk është parapa në KABK, a keni menduar për një parcelë publike dhe cka do të ndajmë për tregun e qytetit. Gjithashtu kam vërejtur nga KABK e kaluar dhe kjo që projekti i rrugës Ismail Raka nga shtëpia e kulturës der tek Xhamia e Dëshmorëve është fshirë tërësisht nga plani kapital, arsyen pse kur ju veq e keni premtuar edhe tek elektorati, tjetra në investimet kapitale a është shpërndarja e njejtë? Në vitin 2027 për blerjen e një automjeti për nevoja administratës komunale ndahen 45,000€

kur në të njëjtën vit për rrugën Runjevë-Stagovë-Kacanik i Vjetër ndahen 10,000€, ndërsa për stadiumin e qytetit në Stagovë ndahet shuma qesharake prej 5,000€, kjo tregon se komoditeti i zyrtarëve vjen para infrastrukturave.

Kryesuesi i Kuvendi: Urdhëroni drejtor nëse keni sqarime të nevojshme.

z. Valdrin Dogani: Po i përgjigjem shkutimisht zonjës Kadrie, e përmendi rrugën Ismail Raka, nëse e ke vrejt që e kemi një kod buxhetor tek Drejtoria e Urbanizmit Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonën urbane të komunës së Kacanikut, ky kod i mbulon të gjitha rrugët në Kacanik, edhe fillimisht e thashë që kjo është KAB nuk është Propozim Buxheti, ka dallim. Sa i përket stadiumit nuk muj pa e përmend (kuprohet që ne e kemi lënë një shumë pak më të vogël) sepse e kemi pa në Ministrinë e Sportit, që i ka të ndara 400,000E për vitin 2026, për stadiumin “Besnik Begunca” në Kacanik, mirëpo nuk po merr kurrfar vendimi, e nëse e ndërton stadiumin ministria, nuk kemi nevojë me nda mjete është logjike. Kemi edhe kodin e projektit 45064, 5,000E në 2026, nëse nuk e bën Ministria i kemi 8,000 E në vitin 2028, dhe 150,000 në vitin 2029, total për këto tri vite është vlera 235,000 E, me atë që kemi kapacitetet ne, sepse kuptohet që ai ka vlerë më të madhe.

znj. Ardita Rrahmani: Desha me u ndërlidhë tek prioriteti 4 ku flitet për fuqizimin e komuniteteve përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale, aty përmendet edhe investimi në infrastrukturë arsimore, këtë rast në objektin e shkollës fillore “Emin Duraku”, thashethemet janë që procedurat kanë përfunduar në E-prokurim në ministrinë e arsimit, se kuptohet që investimet në objekte arsimore i mbulon ministria e arsimit, jam e interesuar me ditë sa është e informuar komuna kur do filloj procedura e ndërtimit të objektit sepse jemi në fund Qershorit dhe sic e dimë procesi mësimorë vec se ka përfunduar edhe jam e bindur, planifikimi për atë numër nxënësish të asaj shkolle ku do të shkojnë, nuk bëhet fjalë vetëm për nxënësit por edhe procesin mësimor, a ka komuna informatë se cka po ndodh me Emin Durakun, ose a vjen najkush vec me pre ndonjë shirit.

z. Sabedin Vishi: Sa i përket KAB 2027-2029 u dëgjova me vëmendje shumicën cka thatë deri më tani por me thënë të drejtën nuk po pajtohem me mendimet e juaja për shkak se janë të inkorporuara shumica edhe pyetjeve që i keni bërë se lëre më kërkesat e qytetarëve, unë kam mbajtur personalisht takim dëgjimi me qytetarët dhe jemi mundu me përfshi në përputhje me Buxhetin e Komunes së Kacanikut direkt ato kërkesa që më së shumti i prekin qytetarët e komunës së Kacanikut, e di që kemi pasë nontop kërkesa për ujë e pijës, dhe ju jeni dëshmitarë që e kemi bërë një kontratë në vlerë afro 3 Milion Euro që pritet për 12 deri 16 muaj të përfundoj dhe që ti japim njëherë e përgjithmonë fund problemit të ujit të pijes në gjithë teritorin, kjo ka qenë kërkesë edhe e juaja edhe e qytetarëve. Kemi bërë kërkesë për parkim, e kemi në investime kapitale për vitin e ardhshëm mjetet për parkim. Kemi bërë kërkesë të vazhdueshme për sallë të kuvendit, keni thënë se spo rrihet në këtë sallë, kjo i bie më shumë atyre që kanë qenë edhe legjislaturën e kaluar, e kemi të ndarë buxhetin edhe për sallë. E kemi bërë jo vetëm ju po kërkojnë qytetarët për qentë endacak, a e kemi lexu, e kemi nda buxhetin edhe për qentë endacak, vazhdimisht kemi fol për rrugën Skëndebeu tek gjimnazi, trotuarin e kemi edhe këtë, kemi fol për terrene sportive, i kemi, salla edukatës fizike në dubravë, sa i përket kanalizimit, rrugët urbane rurale, kjo vjen me kërkesat tuaja sepse nuk mundemi me bërë procedura dhe projekt të vecant për cdo rrugë nga 100m sepse ju e dini procedurat e prokurimit janë të gjata dhe mund të dështojmë, prandaj përderisa na lejon ligji për rregullimin e rrugëve rurale ta zëmë 300,000 euro atëherë kërkesë shqyrtohen sipas rëndësisë, prioritetit mundohemi me i përfshi dhe rregullu për qytetarët e Komunës së

Kacanikut. I përmenda disa që janë më të rëndësishme për Komunën e Kacanikut e mos të flasim për krejt me ju marr kohë, po vec du me ju thanë se krejt qeto janë në përputhje me kërkesë e qytetarëve po personalisht edhe me tuajat. Shkojmë tek shkolla “Emin Duraku”, planin për nënësat e kemi komplet gati zonja Arditë, e sa i përket procedurave ne krejt cka dimë, dimë që është shpallë përfituesi por nuk kemi kurrfar informacioni, me u thënë të drejtën që shumë herë i kam thanë Drejtorit me ba një kërkesë për takim por përkundër kërkesave që i ka ba me emaile, e kemi dërgu edhe zyrtarë tonë atje por të jeni të bindur se nuk ka pasë as staf atje e as kurgjo, tjrtra

Znj. Hafize Sallahu: Deahta të ndërlidhëm edhe tek plani dhe deshta edhe me përgëzu kryetarin, uroj që të vazhdoj deri në fund të mandatit me realizimin e premtimeve që i ka dhënë. Për mua është shumë shqetësuese moskalimi i projektit të Shtëpisë së Kulturës, duke pasë parasysh që kam qenë drejtoreshë dhe kam punu jashtëzakonisht shumë në atë drejtim duke bërë kërkesa të vazhdueshme, besoni që është tmerr që është hjek ai projekt, shpresoj shumë të bëhet por derisa është pezullu ai do mbetet jashtë investimi, edhe pse të gjithë ata ata që e shfrytëzojnë atë ambient e dinë cila është gjendja e saj pavarësisht që komuna ka bërë renovime të pjesshme të saj por që nuk kanë qenë të mjaftueshme, aty ka rrezik edhe nga instalimi elektrik nga vjetërsia. Ne kemi dërgu gjithë dokumentacionin dhe na është premtu reegullimi i saj por ja, neve si komunë na mbetet me shiku mundësitë për me e renovu atë shtëpi, ne terrene sportive kemi kogja por artistat i kemi keq se nuk kanë ku ti ushtrojnë aktivitetet e tyre.

Islam Gashi: Athëherë po e shohim që kemi një rënie të grantit specifik për arsim për 270 mijë Euro, kjo ka ardhë për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve edhe po e shoh që këto mjete janë largu nga investimet kapitale, cilat investime janë duke u prek nga kjo, a keni pasë investime të cilat tani duhet me hjek dorë apo jo?

Sabedin Vishi: Realisht tek granti specifik për Arsim është e vërtetë që është zbrit një shumë e caktuar, të pasna mbet borxh se më duket e ke përmend edhe digjitalizimin 80 mijë edhe 30 mijë. Për shkak që këtë vit kryhet digjitalizimi, besoj që vitin tjetër e përfundojmë, kjo ka qenë edhe prioritet i nivelit qëndror dhe ka pasë me i digjitalizu shumicën e shkollave, mirëpo ende nuk është bërë asnjë tabelë digjitale nga niveli qëndror dhe e kemi bërë me forcat tona sivjet dhe gjysmën tjetër vitin e ardhshëm. Sa i përket investimeve kapitale, shkolla në Doganaj pritet me përfundu sivjet, dhe po presim me ia nis objektit të shkollës Emin Duraku edhe shpresoj që nuk kemi probleme. Si investim kapital ka qenë aneksi në shkollën Profesionale që është larguar

Islam Gashi: Edhe tek digjitalizimi i Administratës “zyre pa letra” në cilin kod buxhetor janë të përfshira sepse nuk pashë që janë nda mjete për këtë.

Sabedin Vishi: Tek ato të cilat nuk ka të parapara kemi kodin për bashkëfinancim mandej na e hedhim me atë kod. Me donacione apo tjetër.

Heset Malsiu: Janë për tu përshëndetur disa projekte si strehimorja për qentë endacak fabrika e ujit, kjo jep sinjale që ka kulaitet qeverisja aktuale, dmth une e pashë tek prioritetet që nuk janë të parapara në propozimin për projekte kapitale, parkimi nëntokësorë i komunës nuk është askund, nuk e keni pasqyru, të paktën unë nuk e pashë. Tek prioriteti 3 pika 3.1 tek mbështetja dhe Zhvillimi Rural, pikën grumbulluse nuk e pashë që është i mbështetur diku në pasqyrë. Ndertimi i rezervarëve të vegjël të ujit nuk e pashë askund. Krijimi i qendrës së riciklimit, nuk e pashë askund. Këto janë gjëra që nuk po shihen aty

Valdrin Dogani: Tek parkingu tek tabela e investimeve Kapitale e ke ke shërbimet e kujdesit primar shëndetësor e ke të shënuar “ Ndërtimi i parkingut prapa objektit të QKMFsë për vitin 2027 kemi planifiku të ndahen 180mijë dhe për vitin 2028 230 mijë, total vlera 410 mijë Euro.

Selajdin Troni: A ka dikush rreth KAB me shtu dicka, nëse nuk ka athëherë e hedhim për aprovim. 11 për dhe 9 abstenime. Prezent ishin 20, me këtë rast Kuvendi konstaton se mori:

VENDIM

Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;

4. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 941/01-11177/21 të datës 29.04.2021 për lejimin e ndarjes së parcelës Nr. 649-0 ZK Kaçanik PSH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;

z.Selajdin Troni: Pikën e tretë e kemi largu në KPF.

Kalojmë tek pika e katërt, drejtori ka një plotësim ndryshim, ia kalojmë fjalën më pas vazhdojmë.

Korab Krasniqi: Tek propozimi për shfuqizimin e vendimit Propozim 01Nr. 941/01-11177/21 të datës 29.04.2021 për lejimin e ndarjes së parcelës Nr. 649-0 ZK Kaçanik PSH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;, kërkoj që pika dy të plotësohet për shkak se kemi pasë një gabim teknik që ska dalë arsyetimi komplet. Pika dy është shfuqizimi vendimit në pikën 1 bëhet për arsye që ky vendim nuk është ekzekutuar asnjëherë dhe për rrjedhojë nuk janë ndërmarrë veprimet administrative apo investuese për realizimin e tij. Ndërkohë bazuar në nevojat aktuale të komunës dhe PZHIP është vlerësuar se në të njëjtin lokacion ekziston interes publik për realizimin e një projekti tjetër, konkretisht ndërtimin e një parkingu nëntokësor i cili do të kontribuoj në përmirësimin e qarkullimit dhe menaxhimit e hapsirave për parkim dhe rritjen e funksionalitetin e zonës. Për shkak se vendimi i datës 29.04.2021 ka mbetur i pa ekzekutuar dhe qellimi për të cilin është nxjerrë nuk do të realizohet shfuqizimi i tij është i nevojshëm për të lejuar bazën ligjore dhe administrative për procedimin e projektit të ri. Po besoj tash e keni të qartë për cilën parcelë është fjala. Kam disa fotografi ekskluzive për juve që ta shihni më mirë. Dmth është kati -2,-1 dhe përdhësë.

Kadrije Lika Troni: Edhe pse po na i dërgoni pikat në kuvend ne nuk po e dimë cka po shfuqizojmë, pa e ditë se çfarë plane investive ka aty. Ne këtu jemi për të shfuqizuar gjëra apo jo bash pa e ditë për cka. Unë këtë e kam ditë. Parcela 00649, ku është ndërtuar objekti i QKMFs në pjesën më të madhe të saj me vendimin e mëherëshëm është ndarë në tre parcela 006491, 006492, 006493 me këtë rast dua të potencoj një joseriozitet të kolektivit komunal që bëhet na vazhdimësi, në atë vendim të vitit 2021 pika 6-të të DU sektori i Kadastrit është obliguar ti bëj ndryshimet në regjistrat e pronës së opalujtëshme pas afateve ligjore të përcaktuara, asnjë nga këto rekomanduara nuk është kryer deri më sot. Kjo gjë vërtetohet nga certifikat e pronësisë që është pjesëe saj. Edhe pse vendimi i Kuvendit është i detyueshm për DU, kjo tregon se ktu ka joseriozitet të ekzekutivit, fillimisht për ndarjen e kësaj parcele dhe pastaj për procesin e dështuar, për ndërtimin e qendrës së shëndetit

mendor, propozimi ka qenë i paanalizuar, i ngutshëm, i timit lind ideja sot hajde e propozojmë nesër. Kjo vërtetohet se pas 5vitesh e dy muaj, kryetarit i lind serish ideja për shfuqizim. Kjo është ajo që une kam hulumtu edhe pse skemi pasë asnjë info. Neve nuk na dërgohet material apo arsyetim se pse po ndodh kjo.

Korab Krasniqi: me sa di unë në atë kohë kjo ka qenë ide e qeverisjes qendrore, ndarja e lokacionit. Po shihet që asnjëra palë se ka pasë përnime.

Kadrije Lika Troni: Pse nuk e shkruajsh aty drejtor që nuk e pasna pas përnime. Edhe tjetra në atëherë kemi votuar kundër kësaj e këtë herë nuk marrim pjesë në votim për vendimet që i merr kuvendi, qesi vendime që menjëherë i shfuqizojnë.

Sabedin Vishi: Mesa e di une në vitin 2021 është kërku nga niveli qendror të kemi një parcelë të ndarë për një qendër të tillë dhe deri tani nuk është bërë asgjë. Pasi e kemi pa që nuk e kanë bërë, kemi një kërkesë nga investitorë Turk tek Saniteksi, për qendër të tillë rehabilituese dhe po presim përgjigje.

z. Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka e hedhim pikën në votim me ndryshimet nga drejtori. 14 për dhe 6 nuk kanë marrë pjesë në votim. Prezent ishin 20, me këtë rast Kuvendi konstatoj se mori:

VENDIM

Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 941/01-11177/21 të datës 29.04.2021 për lejimin e ndarjes së parcelës Nr. 649-0 ZK Kaçanik PSH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;

5. Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025', hartuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

z. Selajdin Troni: Kalojmë tek pika pestë, këtu kemi pasë një debat dhe me të drejtë, kërkoj nga gjithë drejtorët që ti sjellin pikat me kohë përndryshe jam idhtar që nëse nuk jemi të informuar për materialin nuk do ti kaloj për kuvend.

Valdrin Dogani: Shkurtimisht, u mundova me e kry punën shpejtë, andaj ja përcjella zyrës së kuvendit duke e ditë se ishte mbledhja afër, por qysh po e shoh pasna gabu. Ky është një dokument raport mbi gjetjet që e harton zyra ndërkombetare e auditimit, për zbatimin e rekomandimeve, i bijke që në korrik të flisnim prap për këtë raport andaj e propozova. Raporti ka ardhë javën që shkoj, ka në total 13 gjetje, 5 janë të reja 7 janë të përsëritura dhe 1 është pjesërisht e përsëritur. Qështjet me shkronjën A janë të reja, B të përsëritura dhe C pjesërisht të përsëritura. Dicka që ka ndiku jo vetëm tek komuna jonë është kontrata kolektive e cila po paraqet keqklasifikim të shpenzimeve.

Kadrije Lika-Troni: Materiali na ka ardhë me vonesë, duhet ta dinë gjithë kolegët se për atë që kemi folë në KPF në Ligjin për Qeverisjen Lokale, materiali për mbledhje duhet të vijë 7 ditë pune më herët, gjithashtu edhe nëse ka mbledhje urgjente materiali duhet të vijë 2

ditë pune. Neve na ka ardhë materiali të premtën dmth asnjë ditë pune dhe ai ishte reagimi ynë atë ditë.

Valdrin Dogani: Kjo nuk është një material ose çështje për votim është vetëm informatë, ne jemi pajtu me ato gjetje mbetet vetëm me u përmirësu.

Kadrije Lika Troni: Ne jemi me ju ndihmu edhe juve kur keni ndonjëherë probleme kjo është e patolerueshme, me e shkel ligjin komplet edhe mos me reagu është komplet e patolerueshme. Procedura ka qenë e shkelur, ne nuk e kemi pasë asnjë ditë as një 24 orësh në dispozicion.

Ernesta Krasniqi: Edhe pse ky material e kemi cek qe ka ardhë me vonese, duke e dite rëndësinë dhe po me vjen shumë keq që drejtori po thotë që e kemi veq se informatë dhe nuk kemi cka të bëjmë, normal që keni me u pajtu me këtë raport por duheni me ditë që është një prej raporteve më të rëndësishme që diskutohet ne KK, e nuk duhet me ja hup vleren, por duke e ditë rëndësinë ne prap diskutojmë dhe e shtjellojmë. Raporti është raport i kualifikum dhe është më i keqi i mundshëm, pasqyrat financiare janë të sakta sipas raportit po ka disa gabime që ndikojnë në besueshmëri, atëherë kur ndikon në besueshmëri ndikon tek gjithësecili nga anëtarët e kuvendit po besoj dhe të qytetarëve se si po shpenzohen mjetet Komunale. Si fillim do ndalem vetëm në disa gjetje, auditori ka konstatuar se Komuna ka lidhur 5 kontrata pa fonde të mjaftueshme buxhetore. Kjo do te thotë se janë marrë obligime financiare pa pasur mbulim të sigurtë në buxhet si është e mundur që një institucion të nënshkruaj kontrata qindra mijë euro pa pasur fondet e garantuara. Kjo nuk na tregon vetëm një papërgjegjësi administartive po na tregon një keqplanifikim serioz që bart barrën e gjetjeve të viteve të ardhëshme dhe vendos komunën në rrezik për obligime që mund të mos i bërballoj. E dyta, auditori ka konstatuar se është tejkaluar vlera e kontratës për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nuk e di sa po ju kujtohet edhe juve drejtorave por edhe juve kolegëve asambleist, kur une ktu debatoja pikërisht për këtë kontratë e cila është vlera 475.000€ e cila është shpenzu dhe vlera e saj ka arrit rreth 522,000€ pra rreth 47,000€ më shumë se vlera e kontraktuar. Perkundrazi debatit Kryesuesi kur i sheh shokët keq e ndal diskutimin dhe nuk don me disku, po mvjen mirë që jeni pajtu me këtë raport se kur diskutojsha unë për këtë kontratë asnjëri nuk u pajtonit. Mbi të gjitha kjo kontratë as në E-Prokurim nuk është. E kur kemi disku para 3/4 mbledhjeve nuk ka qenë as emri i menaxherit i shënuar. Cfarë mbikqyrje është bërë mbi këtë kontratë, kush e ka lejuar këtë tejkallim, kush mban pergjegjësi. Po tjetra kjo kontratë ka qenë edhe për pastrimin e trotuareve dhe tash po marrim përgjigje. Në kontratën kornizë të lëshuar për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale e nënshkruar më datë 12.01.2024 në vlerë 475,000€ e cila nuk gjendet më në E-Prokurorim, sipas përshkrimit të pozicioneve sic është përcaktu me kontratë, kjo pasi që tek kategoria e parë ishte kontratuar 40% apo 190,000€ ndërsa shpenzimi për këtë pozicion ka qenë vec 5€ në këtë kategori ka qenë mirëmbajtja e trotuareve. Dmth keni planifiku 190,000€ dhe i keni harxhu vetëm 5€ në këtë kategori ndërsa në kategoritë e dyta e të tjera. Ku vlera e shërbimeve shkon deri në 50 euro i keni shpenzu ma shumë. Kategoria e dytë, ishte kontratu rreth 10% apo 142,000€ kurse shpenzimi ka qenë 361,000€ aty ku shërbimet janë me cmim më te lartë aty keni pasë interes për me shpenzu. E treta, raporti evidenton se komuna nuk ka regjistru të gjithë pasuritë e saj dhe disa projekte të përfunduara vazhdojnë të veprojnë si investime në proces, kjo dmth se askush nuk ka një pasqyrë të saktë të pasurisë komunale, si mund të menaxhohet një komunë e cila nuk diket saktësisht se çfarë pasurie ka, pasuria publike nuk është pronë e askuj, është e qytetarëve dhe duhet që evidentohet dhe mbrohet me përgjegjësi maksimale dhe mbitëgjitha më shqetëson fakti se shumë nga këto gjetje nuk janë gjetje të reja, kjo dmth nuk kemi të bëjmë

me një gabim që rastësisht por kemi të bëjmë me një model të vazhdueshëm. Prandaj sot nuk mendoj që duhet të presim deklarata që do të përmirësohemi sepse këtë r kemi dëgju me vite e vite, kush mban përgjegjësi për këto gjetje, cilat masa disiplinore janë ndërmarrë dhe pse kuvendi e qytetarët duhet të bësojnë se vitin tjetër nuk do të lexojnë të njëjtat shkelje apo më keq.

Valdrin Dogani: Ernesta tha vite e vite, vec me ta kujtu është viti i dytë që na vjen raporti i modifikuar viteve paraprake, ka qenë i pa modifikuar. Cështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit, klasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike. Nëse i ki mjetet dhe hyn thesari ti ekzekuton afër 1 milion e 300 mijë euro pagesa, qysh ke me lidh kontratë ti, qysh ke me ja ofru shërbimin qytetarit!

Jeton Luma: Sa i përket ardhjes së këtij materialit, nëse e keni përcjell materialin komplet, këtu është letra e konfirmimit nga kryetari dhe ktu kur e ka konfirmu kryetari figuron data 16 Qershor, sot jemi data 29, prej atëherë janë 13 ditë dhe nuk besoj që ti ke ndërhy në material, ti e ke marrë të gatshëm materialin vec me pru në kuvend dhe me diskutu, shumë mirë dhe me plot të drejtë tha kolegja nuk është i parëndësishëm ky auditim, madje është tepër i rëndësishëm se ka gjetje të mdhaja.

Unë spo ndërlidhem në shumë pika po në njërin prej tyre, kryetari shpesh është thirr në transparencë, po këtu njërs prej gjetjeve thotë, mosraportimi nga menaxherët e kontratave në sistemin E-Prokurimit edhe ketu thot mosregjistrimi i pasurisë në regjistrat përkatëz të pasurive jofinanciare ndikon në prezentin jo të drejtë të pasurive në PFV dhe pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv dhe rrezikun që pasuritë të keqpërdoren apo të humbin. Ky raport duhet me u marr seriozisht, ju i keni rekomandimet be, i ke pas 7/8 rekomandime për përmirësim, besoj duhet me marrë masa në këtë drejtim.

Valdrin Dogani: Askush nuk tha që është i parëndësishëm, neve na shërben si bazë për përmirësim ama duhet me ditë edhe një send, aty ku punohet edhe gabohet. Tjetra është letra e konfirmimit nëse e ke lexu mirë është e asaj date, por thotë se përmes kësaj shkrese kam pranuar Draft Raportin, edhe është pajtu me këto gjetje e përcjell tek zyra kombëtare e auditimit, ata në afat prej 7 ditësh e përcjellin Raportin Final (ceshtje procedurale)

Islam Gashi: Fillimisht edhe unë duhet me kritiku që ky raport kaq i rëndësishëm ka ardhë me vonësë dhe shpresoj që nuk është bërë me qëllimin që të mos kemi kohë të mjaftueshme për analizë. Sa i përket këtij raporti Zyra kombëtare e Auditimit na ka dhënë një raport të kualifikuar të pasqyrës financiare të komunës. Një raport i tillë ipet kur ka anomali materiale apo keq deklarime pra po na tregon që pasqyrat financiare nuk janë të besueshme dhe nuk paraqesin një gjendje reale apo fë sinqertë dhe nuk mund të mbështetemi në të, ky raport mbështet dyshimet tona të vazhdueshme mbi transparencën dhe keqmenaxhimin dhe keqklasifikimin të pasurive etj. Mjaftë zhgënjyese është dhe papërgjegjësia e treguar ndaj përmirësimeve të gabimeve të kaluara, nga 13 rekomandime, 7 janë edhe të vitit të kaluar. Ky është një tregues mjaft i qartë i neglizhencës. Cilat janë gjetjet e zyrës së Auditorit? Qështja 1. Tejkalmi i vlerës së Kontratës Kornizë realizimi i saj jo në përputhje me peshën

e caktuar në kontratë, kjo gjetje e auditorit zbulon një parregullsi mjaftë serioze, menyrën se si janë shpenzuar paratë dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Një rast komuna ka bërë dy shkelje, ka shpenzuar më shumë se që ka qenë e lejuar dhe nuk ka zbatuar planin e veprimit. Po si funksionon kjo kontratë? Komuna e përdor këtë kontratë kur nuk e din saktë sasinë se sa ka me ra supozojmë bore dhe sa ka me pasë rrugë të dëmtuara, por thote unë i kam 475,000€ dhe po i peshoj në bazë të përqindjes se cilat shërbimet, ofertuesi më i liri fiton. Komuna i cakton shërbimet që do të kryhen dhe përqindjen, psh. Këtë rast ka nda 40% ka peshu që ka me ba mirëmbajtjen e trotuareve, 30% ka mujtë me vlerësu larjen e asfaltit me makinë, me 20% hedhjen e kripës për borë dhe 10% largimin e borës nga rruga. Tash ktu fillon manipulimi mes komunës dhe operatorit. Ai që peshon më së shumti operatori oferton me cmim më të lirë supozojmë kur kalkulohet cmimi 40% here 10% e kilometrit, 30% here cmimi tjetër dhe total del ofertuesi më i liri po në realitet është më i shtrenjti, tash që këtë komuna e ka peshu më së shumti, e ka kërku supozojmë vetëm 5 euro, atë që komuna e ka peshu më së pakti ka kërku më së shumti dhe për atë e kemi një tejkalim. Qështja b2. Mosekzistimi i pasurive ekzistente, pasuritë mbi 1000€ duhet të regjistrohen dhe ka gjetur dy pasuri mbi vlerën 33,000€ që nuk janë të evidentuara në sistem, kjo i bie që komuna ka mujt me i ble dy vetura ndërkaq nuk janë të regjistruara dhe sdihet ku janë. E njehta ka ndodhë edhe me asetet që kanë vlerën nën 1000€, aty janë gjetur 5 fatura ku komuna ka blerë total mbi 35,000€ por nuk i ka regjistru në sistem. Me përkthi më thjeshtë, komuna ka ble supozojmë laptopë dhe printera dhe nuk dihet se ku janë. Gjetje tjetër e auditorit është edhe keqklasifikim i shpenzimeve në kategori të gabuara komuna ka raportu gabimisht se ka shpenzuar jashtë kategorive adekuate ekonomike, nga kategoria e investimeve kapitale, kjo na jep anomali matreale sepse kemi te kryera investimet kapitale sado që te jeni të postuara se janë investime kapitale realisht ato janë rreth 250 mijë euro, ose pak më pak për shkak se janë paguar pagat, dhe kjo kategori e pagave është nënvlerësuar për 250 mijë euro më shumë se që figurojnë aty. Cështje tjetër është edhe cështja a2, mangësia në raportimin e përfituesve të subvencioneve, komuna dhe një organizatë IRV kanë pasë marveshje për një projekt 2 vjeçar dhe i kanë nda rreth 102,000€ për atë OJQ por bashkëfinancuesi nuk ka sjellë asnjë faturë apo raport për mjetet. Gjetje tjetër është b3. Komuna ka nënshkruar kontrata pa projekte dhe pa pasur para të gatshme në buxhet, auditori ka identifikuar 5 projekte pa pasur mjete, sipas ligjit komunës nuk i lejohet kjo. Kjo realisht lidh zingjirin e dështimeve sepse ke hy në kontratë pa pasë mjete realisht ke me u vonu edhe ne realizim e ne pagesë. Cështja tjetër C1, dhe B4. Në 6 raste auditori ka gjetë keto gjetje të vonesave në realizim, dhe 5 raste për pagesat e vonuara. Komuna nuk mban protokol për faturat e paguara, komuna ka fshehur borxhët në MF për 9 muaj rresht. Auditori ka bërë disa gjetje që lidhen me DAP, cështja A4 për mosregjistrimin e zyrtarëve në listat e pagave me kontratë ku nga mostra prej 70, 45 prej tyre nuk i kanë pasë kontratat e reja të përditësuara, gjetje tjetër është komuna nuk mban protokol fare protokol për faturat e paguara, dhe rrezikohet të merr padi, b6- dobësi në menaxhimin e kontratave dhe gjetja tjetër B2 komuna ka pranuar një zyrtar të ri në vitin 2021 për menaxhimin e pasurive dhe DAP, ka injoruar kërkesën e tij për trajtim të vazhdueshëm gjë që ka ndikuar që mbi 35,000€ pasuri të mbesin të pa rexhistruara në sistemin e pasurive. Ky raport në vitin 2025 ka punësuar rreth 40 puntorë të rinjë. Cështja B5- Mos përmbushje e kërkesës ligjore për inspektim të pronave të paluajtëshme, cështja A5- Mangësi në funksionalizimin e njësisë së brendshme të auditimit, a3- vonesa në deponimin e të hyrave vetanake. Pra në këtë rast mjetet e deponuara nga QKMF nga Janari në Korrik nuk janë deponuar po janë deponuar në muajin Gusht.

Ardita Rrahmani: Gjatë diskutimeve ajo që më ra në vesh u tha që ky auditim ndikon në besueshmërinë e kuvendit komunal, pse? E dyta u cilësua më herët nga kolegët si dokument

i parëndësishëm, kush e cilësoj? Cili se nëse dikush e ka cilësu si të parëndësishëm une jam me ty, pajtohem që materialet nuk duhet me ardh një orë, dy ditë para, le të jetë kritikë për secilin drejtor të ekzekutivit, por dokument qenka kaq i rëndësishëm sa ju po thoni e po pretendoni se të tjerët nuk po e thonë po të isha në vendin e juaj gjumi nuk më kish zanë me ardh tnesërmen nmëngjes me diskutu këtë punë e jo me prit një muaj për seancën e ardhëshme. Veç pak, jo jo, nëse është i parëndësishëm mezi spres me ardh me than e kam gjetë ekzekutivin gabim dicka, nuk kam nevojë me prit për 32 faqe gjetje 1 muaj ditë me shty mos mi majt të informuar qytetarët se cka po ndodh, e krutoj materialin që vjen me vonesë. Pasi ska diskutim smundesh me thënë se e cilsojnë të tjerët si të parëndësishëm.

Ernesta Krasniqi: cka diskutuat ju për këtë raport është në dilemë të madhe, kishte me qenë mire me dëgju. Ky raport ndikon në besueshmërinë e anëtarëve (ndaj ekzekutivit) dhe qytetarëve jashtë.

Ardita Rrahmani: Nuk e the ashtu!

Ernesta Krasniqi: E thashë. Ne nuk kemi asnjë ndëshkim ligjor nëse votojmë, ata të cilët kanë janë ekzekutivi, ne nuk kemi përgjegjësi përveq përgjegjësisë morale.

Jeton Luma: Unë nuk thashë që është i parëndësishëm, drejtori mu duk që e cilësoj ashtu, kur tha kolegja që duhet me ardh ma herët nuk është po shumë i rëndësishëm, po nëse kam gabu kërkoj falje. Une do e shqyrtoj prap, e dyta, mos tkapemi personalisht sepse sjam i interesuar, çështja C1- vonesa në realizimet kapitale, edhe ne herën e kaluar e kam fol për një fushë sportive e cila ka pasë afat ligjor 60 dite ka përfunduar pas 150 ditësh, nuk po diskutoj edhe më shumë, kjo është një fenomen jo shume i mirë, ndikon te qytetarët dhe tek kualiteti i punimeve. Vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara, bë momentin që nuk i bën pagesat me kohë lind mundësia me u ballafaqu me padi gjyqësore, ne boll e kemi buxhetin e dobët, unë mendoj që këtë mandat duhet të bëhen punët njëherë e mirë, e kam diskutu edhe heren e kaluar, ne nëse bëjmë një punë mirë më mirë i shtojmë edhe disa mijë auro dhe e bëjmë punën në rrëgull me fillim. Kjo praktikë duhet të ndryshoj, një rekomandim nga une.

Arian Teneqja: Më duhet të sqaroj për anëtarët e ri të kuvendit se raporti gjithmonë ka qenë i pamodifikuar nga vitet e kaluara dhe në saj të kësaj ka fituar fonde nga granti i performances diku vit për vit nga 300,000€, përjashtimisht këto dy vitet e fundit raporti është i kualifikuar, për arsye të kontratës kolektive që tha drejtori dhe keqklasifikimi i pagesave prej kuategorive jo adekuate ndërsa për gjetjet tjera edhe kësaj here do vinte i pamodifikuar. Dua të sqaroj për kontratën e mirëmbajtjes verore dhe dimërore që u përmend, ajo është kontratë kornizë, me cmime për njësi që duhet të kryhen, varësisht nga rëndësia e punës kategorizohen në peshë nga përqindja, po planifikimi nuk është i njejtë pasi që është problem ti përmbahesh asaj, ska mundësi me parashiku sa reshje bore do kesh, përsëri ka ndryshime në realizim, apo shembjet apo lumenjtë, cka është punuar është paguar sipas nevojës, ne si drejtori e kemi bërë ndarjen e këtij projekti. Nuk ka tejkalim të kësaj kontrate por pagesa është bërë në saje të aneks kontratës dhe për këtë arsye është tejkalimi që e shehni aty.

Ernesta Krasniqi: Pse je pajtu me gjetjet e këtij raporti pasi që sështë ashtu, pse nuk thot ktu aneks kontrata por tejkallim i kontratës, e dyta drejtor, ti si menaxher i këtij projekti pse nuk i ke ndejt gati me e bë pastrimin e trotuareve.

Arian Teneqja: Ai tejkallim është me aneks kontratë por vetëm se nuk e ka shënuar auditorja, është pajtim pjesërisht a po kupton. Nuk qon peshë. Tjetra sic e dini mirëmbajtja dimërore dhe verore kanë qenë në mënyrën më të mirë të mundshme. Pastrimi i rrugëve gjatë reshjeve ata nuk tpyesin ty a ki planifikim a jo, siguria e qytetarëve duhet të jetë në nivel të duhur. Për këtë arsye kjo kontratë nuk është e njejtë me kontratat e tjera dhe tregova edhe më herët masat të cilat i marrim. Ankesa e vetme e jotja që po e përsërit disa herë është pastrimi i vegjetacionit në trotuare në atë pikë kë pasë vërejtje.

Ernesta Krasniqi: nuk je pajtu pjesërisht, je pajtu mos dezinformo. Këtu je pajtu plotësisht jo pjesërisht, fmitë po shkojnë në shkollë përmes qatyne trotuareve e besa spo kam ku me shkel prej barit. Nuk është esenca vetëm te mirëmbajtja e trotuareve është se si i ke shpenzë kategoritë, 190,000€ i ke parashiku me u shpenzu i ke shpenzu vetëm 5€. Deri sa bëhet kontrata dhe i qetni shërbimet janë të rëndësishme ose përndryshe mos e fut fare në kontratë ose leje kontrat paushall ku tmundesh shpenzoji.

Arian Teneqja: Nëse mke dëgju, për me qenë sa ma të saktë në të ardhmen, pa na ardh raporti i auditorit ne i kemi bërë ndarjën në dy projekte të ndryshme, vecmas ajo dimërore dhe vecmas verore, në mënyrë që të mos kemi problem në auditim, sa na ka ardhë neve raporti e kemi përmirësu përndryshe mundesh me pa në E-prokurim

Ernesta Krasniqi: A e di qe ket kontratë nuk e ki në E-Prokurim, nuk është as emri i menaxherit, o kryesues nuk mundesh ti me udhëru drejtorin, unë kam nevojë me mu përgjigj drejtori, kam pyetje hala une, une se kum perfundu, kum diskutu për të njejtën kontratë, kur më thojshin janë tri kontrata janë dy kontrata, kjo është keqmenaxhim i juaji, pikërisht e ju keni qenë menaxher i këtij projekti, atëherë ju kam thënë turp, po apet duhet me ju thënë turp, se kjo është ndodhi që po përsëritet.

Selajdin Troni: Kjo është ofendim.

Ernesta Krasniqi: Ofendim? Duhet me kuptu njëherë cilat fjale jane ofenduese o Kryesues, lexo cilat janë ofenduese, ti kërko falje për fjalët ofenduese që i ke thënë në KPF e të nderuar kolegë po me vjen shumë mirë qe na edhe pse kemi qenë pjesë e KPF, për këtë raport kemi thenë kritika të mëdha që ky raport duhet me ardh ne kohë, e duhet me qenë ma me pas kohë me diskutu, prap na e kemi gjetë kohën dhe e kemi diskutu, tjetra antarët e KPF edhe pse ishin pro, ska lidhje, se ky raport ska rëndësi që ka ardhë me vonësë se është vec raport e diskutojmë në kuvend, nuk pashë asnjë diskutim e asnjë kritikë për gjithë këto gjetje që i kishte bë auditori.

Islam Gashi: Atëhere unë kam një pyetje për Drejtorin e DShPE pa marrë parasysh a ka qenë ky apo ndonjë tjetër, si e shpjegon faktin që tek kategoria 1, ku keni pasë të planifikuar 40% të kontratës vlerë 190,000€ ndërkaq në terren janë realizu vetëm 5.23€ a do të thotë kjo që drejtoria e ka dizajnu këtë tender për nevoja të komunës të cilat buk i ka pasë fare apo që operatori ka refuzuar të punoj në ato pozicione. Pse është ky devijim kaq i madh.

Arian Teneqja: Devijimi është për arsye nga nevojat reale që janë paraqitur në terren gjatë realizimit, nuk kanë qenë në harmoni me planifikimin i cili është bërë në fazën e tenderimit, për këtë arsye se nuk kemi mundësi me e ditë në atë fazë se çfarë shpenzime do kemi në atë kontratë varet, tjetra gjë varet se cmimi i njërive të operatorit sa ka qenë, nuk janë shpenzime që ti e ki komoditetin me vepru sic të duash, në këtë kontratë ti je i obliguar detyrimisht me e kry shërbimin.

Islam Gashi: Kontrata është detyrim për dy palët, nëse ti planifikon 40% edhe kompanisë i thu ki me kry, momentin që ti e nënshkruan ai e pranon këtë gjë, kjo ka qenë gjetja kryesore e auditorit, kur kalkulohet cmimi ai 10 centëshi në 40% ndikon që ai operator me qenë shumë i lirë, cka bën ti në këtë rast nëse sja ofron këto shërbime kompania, këtë rast një ofertues shumë të sinqertë që e ke pas e ke humb sepse ka dal në cmim pak ma i shtrenjtë, realisht ky më i liri ka dalë më i shtrenjtë. Ti, drejtoria është dashtë me e kërku që me e kry kompania përqindjen nëse ka ofertu me 10 cent e jo me pas devijim aq të madh. Planifikimi dhe realizimi kanë diferencë shumë të madhe që lënë dyshime për manipulim.

Arian Teneqja: Në rast se je menaxher i kontratës ti dhe arrin 40% e një pozicioni që e ke aty edhe tash ty të mbyllet një rrugë. Cka ban ti? Ti ki hapsirë në kontratë edhe një pjesë tjetër. A e kalon atë përqindje në kontratë apo nuk e hap rrugën. Nëse ka shembje, e ke në planifikim 40% e ke plotësu me nevoja, nëse ki mjete, ti a thu nuk po dal pe hapi se mkalohet përqindja në kontratë, a po kupton.

Islam Gashi: Veç pak se koka interesant qysh paski zgjedh me hjek te qekjo ma e lira, pse ske hjek te qajo ma e shtrenjta me kursy mjete po te kjo që ka qenë shumë ma e lirë, kjo është shumë interesant edhe për auditorin edhe për mua.

Ernesta Krasniqi: Drejtor a është edhe një kontratë që është nënshkru në fillim të këtij viti për mirëmbajtjen e rrugëve dimërore, se sju ka dalë kjo kontratë, që ka qenë në fillim të këtij viti deri ka Maji nëse nuk gaboj.

Arian Teneqja: Mke kërku me ti dërgu kontratat, se ske mujt me i gjet në E-Prokurim, ti kam dërgu të gjitha në email.

Ernesta Krasniqi: Emailët zyrtarë nuk kanë kapacitet nuk me ka ardh asgjë.

Selajdin Troni: Kapaciteti është shtu.

Islam Gashi: Atëherë në bazë të raportit të auditimit e pamë që janë punësu edhe 40 punëtorë të rinjë, komuna paska pasë buxhet 40 puntorë të rinjë vitin 2025 i cili ka qëllim edhe vit zgjedhor por pse nuk ka pasë mjete apo pse ndokënd prej 40 puntorëve nuk e keni plotësu numrin tek Tatimi në Pronë pse nuk bëhet inspektimi i pronave dhe pse kemi pabarazi në tatim, dhe komuna humb nga mosinspektimi i atyre pronave por i keni pozicioni me pozita tjera, gjithashtu njësinë e auditimit të brendshëm e keni vetëm me një Auditore ndërkaq sipas ligjit kërkohen tre, pse nuk i keni plotësu edhe ata në mënyrë që me pasë kontrollë ma efektive e që mos me ardh deri tek këto shkelje apo gjetje të auditorit, po mu parandalu nga kontrolla e brendëshme.

Kadrije Lika Troni: Ku jemi tek vonesat tek projektet kapitale, punimet në 6 raste kapitale nuk janë kryer sipas plant dinamik dhe nuk ka pasur amandementim në kontratë, dmth rruga Stagovë-Runjevë, troturari segmenti Natyra- Fusha e Pajtimit, lidhja e Kacanikut me rrugën nacionale N2, Parku i qytetit përballë Kalasë, shkallet tek Guri i shpuar. Gjitha këto projekte janë me vonesa, cka keni ndërmarrë ju, a keni marrë ndonjë përgjegjësi apo ndëshkim për menaxherin e projektit e për kompaninë, apo vetëm jemi duke i lënë që ta kenë si në fushë çkadojnë me ba, vonohen 70 ditë nuk merret dicka, pastaj tek shkallet mbi Gurin e Shpuar, pasi u përmendën edhe shembjet nga drejtori. Ne në të njëjtën kohë kemi pasë shembje edhe pa u bërë një vit nga projekti dhe keni thënë që i ka një vit në dispozicion kompania me i krye, ajo veq në fillim paska pas vonesë, edhe limitin një vjeçar me siguri e ka kalu që është dashtë me ndërhy. Po më intereson a po dënohet menaxherët dhe operatorët me këto vonesa.

Betim Shala: Gjetja e auditorit tek kontrata kornizë rreth planifikimit dhe realizimit sipas planifikimit, tek projektet të cilat janë për një rrugë apo dicka, secili projekt qysh në menaxhim ndërtimtarie në fakultet të ndërtimtarisë msohet se mundet me pasë devijime deri në 10% të projektit, te kontrata normale. Fjala manipulim nuk bën mu përgjithësu se ne nuk po dimë cilat janë realizu dhe cilat jo, është dashtë me bërë kërkesë në dokumente zyrtare, ktu sduhet me shkru, unë deshta me thënë që të mos përgjithësohet si problem si me dal te fjala manipulim po me qenë i sigurtë, kontrata kornizë mundet me ndrru shumë raste, po tregoj prej përvojës. Për atë edhe ligji e parasheh që dallon projekti ideor nga i zbatimit.

Islam Gashi: Ti the se lejohet deri në 10%.

Betim Shala: nuk thash lejohet thashë që kur ka projekt kryesor mundet me pas devijim deri 10%. Deri 30% ndryshon projekti kur kryhet pa projekt, spe arsyetoj askënd, po vetëm po them mos me u përgjithësu.

Islam Gashi: Edhe unë e kuptoj që nuk mundet me u ba gjithëcka 100%, tolerohet masa e gabimit +/-, po aty shënojnë që ka me u ba 40% me matematikë time është planifiku 190,000€ me 5€ është diferencë e madhe. Pse u peshu dicka që ska pas nevojë hiq apo pse është kërku nga operatori me e zbatu këtë, janë dy që kanë kërku cmim të lirë dhe realizimi është shumë i vogël, a realisht komuna kish pas interes me kërku me u krye ato shërbime, peshimi ndikon edhe te zgjedhja e ofertuesit, cili po del më i liri. Me matematikë del se 40% merr pjesë shumë, ai ofertues i sinqetë ka ardhë me cmime të tregut.

Ernesta Krasniqi: Ti po diskuton vetëm në bazë të fjalëve që jemi duke i diskutu ne, se ti raportin po thu se nuk e ke lexu.

Selajdin Troni: Le ta kryen bre

Betim Shala: Nuk thash se kam lexu raportin, nuk e kam lexu saktësisht pozicionin të cilat janë, a e ke lexu ti cilin pozicion janë 2.3/3.2/4.2 i paramasës.

Ernesta Krasniqi: kam qasje në dokument zyrtar që ta tregoj dokumentin zyrtar, të rujt e kam, dokumenti para shumë kohësh kur ka qenë aktiv unë e kam marrë e kam rujt. Ti sun përgjigjesh për mu, kjo është kryesorja.

Ardita Rrahmani: Për ato hamendësimet e tua që të shkojnë nëpër mendje ty smundem me tu përgjigjë.

Ernesta Krasniqi: A pe lypni takatin, që ku është pozicioni, që ku janë pozicionet.

Ardita Rrahmani: Me cilin takat oj Ernestë, me çfarë takati do mu shty me mu? Kujdes për fjalorin, nuk është hera e parë, nuk ki drejtë me përdor ate fjalë.

Ernesta Krasniqi: Edhe ti shumë kujdes, ti sjep përgjigje për mu.

Selajdin Troni: E kalojmë fjalën tek kryetari!

Sabedin Vishi: Edhe pse drejtori u përgjigj po mundohen me u përgjigj edhe unë pasi u drejtove direkt, the për 40 punëtorë.

Selajdin Troni: Pe kaloj fjalën tek Heseti pastaj tek ti kryetar nëse ka mundësi.

Heset Malsiu: U thanë të gjitha gjërat që u desht mu thanë për raportin, mirëpo shqetësuese për mu ishte se viti elektoral është pa me qeto investime.

Sabedin Vishi: Islam the 40 puntorë, rastësisht ka qëllu me qenë 40 puntorë në vit zgjedhor, veq e di që ne si administratë e kemi nr. e caktuar te punëtorëve dhe ne nuk mundemi me shku po nëse del dikush në pension apo tek granti specifik i arsimit apo i shëndetësisë me shtu edhe 5 numra apo 6 numra nëse kemi hapje të reja. Kan me kanë cdo vjet kto numra, por këtë e di që nuk ka poste të jashtëligjshme. Thatë a keni marrë masa për projektet, tek rruga Reshat Shehu janë marrë masa ndaj operatorit, tek nënkalimi janë marrë masa ndaj operatorit, nëse nuk gaboj edhe tek sheshi. Po pse po na përcjellin këto vonesa, alokimi i buxhetit është vonuar më shumë se asnjëherë, tatimi në pronë është vonuar më shumë se asnjëherë tjetër, këtu e kemi edhe drejtorin që ka qenë, nënkryetar aktualisht, një pjesë e grantit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake të cilat mblidhen nga tatimi në pronë, e nëse nuk

dalim faturat prap kanë me nau përsëritë vonesat neve. Edhe tek zotimi i mjeteve, të hyrat vetanake ne i vendosim 50 mijë euro dhe na kërkohet me u zotu me ato të hyra menjëherë skemi ku me i gjetë, mandej kontrata me prokurim qysh kanë krejt tjerat, ne duhet patjetër nganjëherë me ba kategorizime, edhe pse nganjëherë bëjmë shkelje për me pagu dicka më urgjent. E thatë kontrata pa mjete financiare, po une po them që kemi lidhë kontratë për Emin Durakun, mos keqkuptoni nëse 80% të punëve i bëj mirë 20% them se nuk kam mund me i bë, nuk ka asnjë institucion që i përfundon 100% të punëve, të gjithë kanë raporte të modifikuara shkak i kontratës kolektive. Është e dhimbshme që shumica e mjeteve nuk shkojnë tek arsimtarët po tek gjykatat e kto, ne kemi pasë vendime që i kemi refuzu shpesh, kush i kontrollon gjykatat, ndoshta i kontrollon najkush Tek tatimi në pronë kemi me përmirësu sivjet, kemi bë mbledhje, kemi me dhënë maksimumin me eleminu, këto gjetje për neglizhencë kemi me i përmirësi maksimalisht. Kemi 10 vite rend që raportin e kemi të modifikuar.

Xhelal Dema: Nesër është dita e fundit e pagesës për tatimin në pronë, pasnesër duhet me pagu me denim, sepse faturat skanë ardhë.

Ernesta Krasniqi: A keni bë ndonjë njoftim ju që me e pagu qytetarëpërmes E- Kosova, apo me ardhë ktu.

Xhelal Dema: Po ne kemi bë njoftim.

Kadrije Lika Troni: A është dke funksionu zyra e prokurorimit, sepse disa mu kanë anku, se zyrtari ishte në pushim.

Sabedin Vishi: Zyrtari ka pasë një lëndim, zyrtarja tjetër është në punë, janë në kordinim sëbashku, por zyra po funksionon.

Jeton Luma: Kam një pyetje për Arditën, a ke ti ndonjë ankesë apo dicka për raportin e auditimit.

Ardita Rrahmani: Po i nderuari Jeton, ama veq një send sham shumë e kënaqur, ekzekutivi është pajtu me cdo gjë që ka gjetë auditori, vijën institucionale se do punë nuk varën vetëm prej nesh, un kam durim e po pres, nëse nuk përmirësohen atëherë flas.


Hafize Sallahu: Kryesues tlutem mos me i lan me fol se ktu kanë nis me diskutu mesvete.

Islam Gashi: Këtu janë gjetë 7 gjetje nga viti i kaluar, pse nuk the asgjë për kto?

Ardita Rrahmani: Pikërisht për këtë ne kemi bë vërejtje dhe kemi diskutu, qysh mundesh me i kërk u llogari për dicka që nuk është i thirrur, o djal jemi duke fol për raportin e vitit 2025.

Mbledhja i përfundoj në ora 13:21.

Procesmbajtës
Arianita Bajrami



Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

